



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.42

2006

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.220, datë 19.4.2006	Për dhënie fondi ndihme, Partisë Demokratë për Integrim e Prosperitet..... 1303 ...
Vendim i KM nr.221, datë 19.4.2006	Për një ndryshim në vendimin nr.309, datë 12.5.2001 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Qendrës Kombëtare Arsimore të Vlerësimit dhe të Provimeve”..... 1303
Vendim i KM nr.223, datë 19.4.2006	Për pagesën e së ardhurës nga papunësia..... 1304
Vendim i KM nr.224, datë 19.4.2006	Për caktimin e nivelit bazë të së ardhurës nga papunësia... 1306
Vendim i KM nr.227, datë 19.4.2006	Për transferimin e truallit dhe të objektit “Hidrovari i qytetit Vlorë”, nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në pronësi të bashkisë së Vlorës..... 1306
Vendim i KM nr.228, datë 19.4.2006	Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr.306, datë 27.6.2002 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe spitalin ushtarak qendror universitar në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e Forcave të Armatosura”, të ndryshuar..... 1307
Vendim i KM nr.229, datë 19.4.2006	Për disa ndryshime në vendimin nr.638, datë 18.9.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të infermieristikës në

Vendim i KM nr.235, datë 19.4.2006	sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë”, të ndryshuar.....	1316
	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.495, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kushteve, të personave dhe sasisë së nevojshme të karburantit për përdorim nga anijet e peshkimit”, të ndryshuar.....	1324
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të zhdukur të shtetasit Ilo Xheladini.....	1326

VENDIM
Nr.220, datë 19.4.2006

PËR DHËNIE FONDI NDIHME, PARTISË DEMOKRATE PËR INTEGRIM E PROSPERITET

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18, të ligjit nr.8580, datë 17.2.2002 “Për partitë politike”, të ndryshuar, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Partisë Demokrate për Integrim e Prosperitet t’i jepet një fond prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh, si ndihmë financiare, në çastin e krijimit.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Ngarkohet Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.221, datë 19.4.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.309, DATË 12.5.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E QENDRËS KOMBËTARE ARSIMORE TË VLERËSIMIT DHE TË PROVIMEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 9 e vendimit nr.309, datë 12.5.2001 të Këshillit të Ministrave ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Qendra Kombëtare Arsimore e Vlerësimit dhe e Provimeve është institucion buxhetor, që financohet nga Buxheti i Shtetit, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.223, datë 19.4.2006

PËR PAGESËN E SË ARDHURËS NGA PAPUNËSIA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 55, pika 1, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfitojnë të ardhura nga papunësia personat, të cilët plotësojnë kushtet e mëposhtme:
 - a) Të kenë kontribuar në sigurimin shoqëror për një periudhë të paktën 12-mujore, për çdo rast përfitimi;
 - b) Të jenë regjistruar si punëkërkuar të papunë pranë zyrës përkatëse të punësimit;
 - c) Të kenë paraqitur kërkesën me shkrim dhe të kenë plotësuar dokumentacionin përkatës, brenda 60 ditëve nga data e lindjes të së drejtës, për t’i përfiturar këto të ardhura. Përjashtim nga ky rregull bëjnë rastet kur personat e papunë janë të sëmurë dhe e vërtetojnë vonesën e kërkesës me raport mjeko-ligjor;
 - ç) Të jenë paraqitur në zyrën përkatëse të punësimit një herë në muaj ose sa herë, që thirren nga kjo zyrë. Në rast mosparaqitjeje, pa shkaqe objektive, humbasin të drejtën e përfitimit të këtyre të ardhurave;
 - d) Të pranojnë të punësohen, kur u ofrohet punë e paguar dhe e përshtatshme nga zyra përkatëse e punësimit;
 - dh) Të pranojnë të kualifikohen ose të rikualifikohen kur u ofrohet nga zyra përkatëse e punësimit.
2. Personave, të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, u paguhet e ardhura e papunësisë:
 - a) për 12 muaj, kur në çastin e lindjes të së drejtës për të përfiturar të ardhurën nga papunësia, kanë kontribuar në sigurimin shoqëror, për një periudhë prej 12-muajsh, dhe nuk kanë përfiturar asnjëherë të ardhur papunësie;
 - b) për 10 muaj, kur kanë përfiturar më parë të ardhura nga papunësia, për një periudhë prej 12-muajsh, dhe për ta përfiturar atë për herë të dytë, brenda një periudhe 24-mujore aplikojnë pas përfundimit të përfitimit të parë;
 - c) për 8 muaj, kur kanë përfiturar më parë dy herë të ardhurën nga papunësia, për periudha kohore, respektivisht, për herë të parë 12 muaj dhe për herë të dytë 10 muaj, dhe për ta përfiturar atë për herë të tretë, brenda një periudhe 24-mujore aplikojnë pas përfundimit të përfitimit të dytë.

Personat, të cilët aplikojnë për të përfiturar të ardhura nga papunësia jashtë periudhave të përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c”, paguhet sipas shkronjës “a”, të kësaj pike.
3. Personat, të cilët aplikojnë për të përfiturar të ardhura nga papunësia, së bashku me kërkesën, duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Librezë pune;
 - b) Certifikatë personale me fotografi;
 - c) Certifikatë gjendjeje familjare;
 - ç) Vërtetim nga dega e tatim-taksave, se personi nuk është subjekt i regjistruar pranë këtyre organeve;
 - d) Vërtetim për ndjekjen e shkollës, për fëmijët deri në 18 vjeç;
 - dh) Vërtetim për vazhdimin e studimeve të larta, për fëmijët deri 25 vjeç;
 - e) Vërtetim nga KMCAP-i për deklarin e paaftësisë për punë, për personat në ngarkim;
 - ë) Vërtetim nga organet e sigurimeve shoqërore, që njëri nga bashkëshortët nuk është përfitues pensioni të plotë;
 - f) Vërtetim nga kadastra, nëse ka tokë në pronësi.
4. Në rastet kur është përfiturar një herë pagesë papunësie, afati prej 12-muajsh i derdhjeve të kontributeve për sigurimet shoqërore llogaritet që nga çasti i përfundimit të pagesës së fundit të së ardhurës nga papunësia.
5. Personi, i cili punësohet gjatë periudhës së përfitimit të së ardhurës nga papunësia, është i detyruar të lajmërojë, brenda 5 ditëve, zyrën përkatëse të punësimit, në të kundërt ai duhet të kthejë

shumën e të ardhurave, që ka përfituar gjatë kësaj periudhe në mënyrë të padrejtë, në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore.

6. Personi, i cili vetëpunësohet gjatë periudhës së përfitimit të së ardhurës nga papunësia, me marrjen e licencës nga organi përgjegjës duhet të lajmërojë, brenda 5 ditëve, zyrën përkatëse të punësimit, në të kundërt ai është i detyruar ta kthejë shumën e të ardhurave nga papunësia, që ka përfituar gjatë kësaj periudhe në mënyrë të padrejtë.

7. Një person, që përfiton të ardhura nga papunësia detyrohet të njoftojë, brenda 5 ditëve, zyrën përkatëse të punësimit, kur:

- a) ka ndryshime në gjendjen familjare;
- b) personat, që janë në ngarkim të tij, kanë mbushur 18 vjeç, dhe ata që studiojnë apo janë të paaftë për punë kanë mbushur moshën 25 vjeç;
- c) kanë ndryshuar kushtet e tjera të përfitimit të të ardhurave nga papunësia.

Në të kundërt ai kthen shumën e të ardhurave nga papunësia, që ka përfituar gjatë kësaj periudhe në mënyrë të padrejtë.

8. Kur zyra përkatëse e punësimit vëren raste të përfitimit në mënyrë të padrejtë të së ardhurës nga papunësia, njofton menjëherë personin për masën dhe datën e kthimit të shumave, të përfituara padrejtësisht.

Zyra përkatëse e punësimit ndjek procedurat e parashikuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, kur një person, brenda 30 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit, nuk kthen shumën e përfituara padrejtësisht.

9. Personat nuk përfitojnë apo u ndërpritet e ardhura nga papunësia kur:

- a) pa arsye nuk pranojnë të ndjekin programe punësimi, me pagesë të përshtatshme, të ofruara nga zyra përkatëse e punësimit, për aq kohë sa zgjasin këto programe punësimi;
- b) refuzojnë, pa argumente të arsyeshme, të marrin pjesë në kurse trajnimi e kualifikimi, me pagesë, të ofruara nga zyra përkatëse e punësimit për aq kohë sa zgjat kursi i trajnimit.

10. Masa e nivelit bazë të së ardhurës mujore nga papunësia është e njëjtë për çdo përfitues.

11. Përfituesit, me plotësimin e kushteve për përfitimin e së ardhurës nga papunësia, kanë të drejtë të marrin mbi masën e nivelit bazë të së ardhurës nga papunësia:

- a) kompensimet në vlerë nga rritja e çmimeve të ushqimeve, çmimit të bukës dhe çmimit të energjisë elektrike, të përcaktuara me vendime të Këshillit të Ministrave;
- b) të ardhura shtesë për çdo fëmijë, në një përqindje të caktuar të së ardhurës nga papunësia, sipas përcaktimeve të bëra në ligj.

12. Ngarkohet Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për nxjerrjen e udhëzimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.224, datë 19.4.2006

PËR CAKTIMIN E NIVELIT BAZË TË SË ARDHURËS NGA PAPUNËSIA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 54, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve

VENDOSI:

1. Niveli bazë i së ardhurës nga papunësia të jetë 5240 (pesë mijë e dyqind e dyzet) lekë në muaj.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2006, grupi 25, titulli 065, kap. 1, art 604 “E ardhura nga papunësia”, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3. Vendimi nr.583, datë 10.9.2004 i Këshillit të Ministrave “Për caktimin e nivelit bazë të së ardhurës nga papunësia”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.5.2005.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.227, datë 19.4.2006

PËR TRANSFERIMIN E TRUALLIT DHE TË OBJEKTIT “HIDROVORI I QYTETIT VLORË”, NGA MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT, NË PRONËSI TË BASHKISË SË VLORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5, 8 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme, publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e truallit dhe të objektit “Hidrovari i qytetit Vlorë”, me sipërfaqe të përgjithshme truall 4631,2 m² nga e cila 171,2 m² ndërtesë, nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në pronësi të bashkisë së Vlorës.

2. Bashkisë së Vlorës nuk i lejohet tjetërsimi ose ndërrimi i destinacionit të objektit “Hidrovari i qytetit Vlorë”.

3. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, kryetari i bashkisë së Vlorës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.228, datë 19.4.2006

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NE VENDIMIN NR.306, DATË 27.6.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË NË SISTEMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE SPITALIN USHTARAK QENDROR UNIVERSITAR NË SISTEMIN E MINISTRISË SË MBROJTJES, SI DHE PËR TRAJTIMIN E MJEKËVE NË STRUKTURAT E FORCAVE TË ARMATOSURA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.306, datë 27.6.2002, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa e ndryshime:

a) Shkronja “ç”, e pikës 9, riformulohet, si më poshtë vijon:

“ç) Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Mbrojtjes përcaktojnë kriteret dhe rregullat për dhënien e shpërblimit, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të këtij vendimi.”.

b) Lidhja nr.1 (Krerët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8 e 1.9.) zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare, për vitin 2006, për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore, të planifikuara për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave, për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 15 prill 2006.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Lidhja nr.1 (Kreu 1.1)

**Struktura e pagave për punonjësit me arsim të lartë në Qendrën Spitalore Universitare
 “Nënë Tereza” Tiranë, Spitali Universitar Obsetrik Gjinekologjik Tiranë, Spitali Universitar i
 Sëmundjeve të Mushkërive “Shefqet Ndroqi” Tiranë, Klinika Stomatologjike Universitare
 Tiranë, Spitali Ushtarak Qendror Universitar Tiranë**

EMERTIMI		PAGA MUJORE					
Nr.		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa per vjeter si (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa per pozicion (SHP)	Shtesa per kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor -QSU “Nene Tereza” Tirane; -Spitali Universitar Obsetrik Gjinekologjik “Koço Glozheni” dhe Spitali Universitar Obsetrik Gjinekologjik “Mbreteresha Xheraldine” Tirane; -Spitali i Semundejeve te Mushkerise “Shefqet Ndroqi”; Spitali Ushtarak Qendror Universitar Tirane.	10050	2%	0	62100		Nga.Deri ...Leke
2	Drejtor -Klinika Stomatologjike Universitare Tirane.	10050	2%	0	38000		Nga.Deri ...Leke
3	Zevendes drejtor.	10050	2%	0	32500		Nga.Deri ...Leke
4	Shef Sherbimi.	10050	2%	0	22850		Nga.Deri ...Leke
5	Shef reparti/klinike (kirurgji, urgjence etj); Shef i qendres se gruas; Shef i sektorit biomedikal.	10050	2%	0	20650		Nga.Deri ...Leke
6	Shef reparti/klinike reanimacioni; Shef reparti/klinike psikiatrie.	10050	2%	0	20650	1100	Nga.Deri ...Leke
7	Shef i laboratorit klinik biokimik; Shef reparti kimioterapi; Shef laborator; Shef i Qendres se diagnoses molekulare.	10050	2%	0	20650	2200	Nga.Deri ...Leke
8	Shef reparti rezatimi; Shef reparti I kyrise.	10050	2%	0	20650	4600	Nga.Deri ...Leke

9	Shef kabineti; Shef laborator; Shef i qendres se protezimit.	10050	2%	0	19100		Nga.Deri ...Leke
10	Shef sektori; Shef farmacie ne solucionet e injektueshme; Biokimist ne solucionet e injektueshme; Inxhinier biomedikal; Inxhinier i sistemeve te ngrohjes; Inxhinier ne hemodialize.	10050	2%	0	16400		Nga.Deri ...Leke
11	Mjek; Stomatolog; Biolog,kimist,fizikant ne preparatori; Mikrobiolog,parazitolog,virolog, mykolog; Pergjegjes qendre DDD; Specialist fizikulture (fizioterapi neurologji); Kryellogaritar; Revizor.	10050	2%	0	14600		Nga.Deri ...Leke
12	Mjek kirurg (specialitete kirurgjikale); Mjek onkolog; Mjek fizioeterapeut; Mjek obseter gjinekolog; Mjek pneumoftiziat.	10050	2%	0	14600	1100	Nga.Deri ...Leke
13	Mjek radilolog; Toksikolog, kimist,ne laboratorin toksikologjik; Kimist ne laboratorin biokimik; Fizikant ne laboratorin biokimik; Biolog ne laboratorin biokimik.	10050	2%	0	14600	1600	Nga.Deri ...Leke
14	Mjek kimiaterapeut; Mjek hematolog; Mjek infeksionist; Mjek ne pranim urgjence; Mjek ne njesine nozokomiale; Mjek laborator; Mjek histopatolog; Mjek ne sherbimin e gjakut.	10050	2%	0	14600	2000	Nga.Deri ...Leke
15	Mjek ne inspektoriatin sanitar; Inspektor sanitar; Epidemilog; Farmacist.	10050	2%	0	14600	2500	Nga.Deri ...Leke
16	Farmacist ne laboratorin toksikologjik;	10050	2%	0	14600	2800	Nga.Deri ...Leke

	Mjek laboratorizotopik; Fizikant, kimist laboratorizotopik; Mjek ne hemodinamike; Fizikant ne higjene dhe epidemiologji; Inxhinier kimist ne sherbimin e higjenes ne SUQU.						
17	Mjek anatomopatolog; Mjek anestezi, reanimator; Mjek ne pavionin e rezatimit; Mjek ne pavionin e kyrise; Fizikant kobalti; Specialist ne Qendren e Diagnoses Molekulare. Biokimist ne sherbimin e mbrojtjes nukleare biokimike ne SUQU.	10050	2%	0	14600	3700	Nga.Deri ...Leke
18	Mjek , psikolge , punonjes sociale qe punojne ne psikatri.	10050	2%	0	14600	4000	Nga.Deri ...Leke
19	Specialist i larte.	10050	2%	0	13275		Nga.Deri ...Leke

Lidhja nr.1 (Kreu 1.2)

Struktura e pagave për punonjësit me arsim të lartë në Drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethe

EMERTIMI		PAGA MUJORE					
Nr.		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa per vjetërsi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa per pozicion (SHP)	Shtesa per kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor dhe Kryeinspektor sanitar	10050	2%	0	33500		Nga.deri ...Leke
2	Drejtor	10050	2%	0	23850		Nga.deri ...Leke
3	Zevendes drejtor	10050	2%	0	16400		Nga.deri ...Leke
4	Shef sektori	10050	2%	0	13275		Nga.deri ...Leke
5	Pergjegjes zyre Specialist me arsim te larte	10050	2%	0	12000		Nga.deri ...Leke
6	Revizor Inspektor	10050	2%	0	12000	1100	Nga.deri ...Leke

**Struktura e pagave për punonjësit me arsim të lartë me Drejtoritë e Kujdesit Shëndetësor
Parësor dhe Shërbimet e Kujdesit Shëndetësor Parësor, Autoritetin Shëndetësor Rajonal të
Tiranës.**

EMERTIMI		PAGA MUJORE					
Nr.		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa per vjetërsi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa per pozicion (SHP)	Shtesa per kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor Ekzekutiv; Drejtor dhe Kryeinspektor sanitar.	10050	2%	0	33500		Nga. deri ... Leke
2	Drejtor.	10050	2%	0	22850		Nga. deri ... Leke
3	Shef shërbimi i kujdesit parësor; Shef shërbimi urgjence; Zevendesdrejtor.	10050	2%	0	16400		Nga. deri ... Leke
4	Shef shërbimi i higjenes; Shef shërbimi i epidemiologjise; Shef shërbimi stomatologjik.	10050	2%	0	16400	3300	Nga. deri ... Leke
5	Specialist i lartë në higjënë; Specialist i lartë në epidemiologji; Shef reparti; Përgjegjës poliklinike; Shef kabinetit; Shef/përgjegjës laboratorit; Përgjegjës dispancerie.	10050	2%	0	14275		Nga. deri ... Leke
6	Epidemiolog; Higjënist; Inspektor stomatolog.	10050	2%	0	14275	1100	Nga. deri ... Leke
7	Shef reparti higjënë; Shef reparti epidemiologji.	10050	2%	0	14275	3300	Nga. deri ... Leke
8	Mjek; Stomatolog; Inxhinier elektrik; Kimist; Veteriner; Mikrobiolog; Shef sektori; Përgjegjës zyre.	10050	2%	0	11900		Nga. deri ... Leke
9	Mjek ftizioterapeut; Mjek kirurg; Mjek ortoped;	10050	2%	0	11900	1100	Nga. deri ... Leke

	Mjek pneumoftiziatër.						
10	Mjek radiolog; Mjek psikiater; Mjek hematolog; Mjek onkolog.	10050	2%	0	11900	1600	Nga. deri ... Leke
11	Specialist i lartë.	10050	2%	0	10300		Nga. deri ... Leke

Struktura e pagave për punonjësit me arsim të lartë në spitalet e rretheve, Qendrën e Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve

EMERTIMI		PAGA MUJORE					
Nr.		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa per vjetërsi (SHV)	Shtesa per Kualifi kim (SHK)	Shtesa per pozicion (SHP)	Shtesa per kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor	10050	2%	0	22850		Nga..deri ...Leke
2	Shef sherbimi ne anatomopatologji	10050	2%	0	19735	3500	Nga..deri ...Leke
3	Zevendes drejtor Shef sherbimi	10050	2%	0	16400		Nga..deri ...Leke
4	Shef sherbimi reanimacioni Shef sherbimi infektiv Shef sherbimi obsetrik gjinekologjik Shef sherbimi kirurgji Shef sherbimi ortopedi	10050	2%	0	16400	1100	Nga.deri ...Leke
5	Shef sherbimi radiologji Shef sherbimi psikiatri Shef sherbimi neuropsikiatri	10050	2%	0	16400	1600	Nga.deri ...Leke
6	Shef reparti/klinike Pergjegjes/shef kabineti Pergjegjes/shef poliklinike Pergjegjes/shef laborator (fizioterapi)	10050	2%	0	14275		Nga.deri ...Leke
7	Shef I bankes se gjakut Shef reparti radiologjie; Shef reparti pneumoftiziatri.	10050	2%	0	14275	1100	Nga.deri ...Leke
8	Shef reparti/klinike psikatri Mjek ne Repartin Infektiv ne Psikiatri Pergjegjes laborator klinik biokimik	10050	2%	0	14275	2500	Nga.deri ...Leke
9	Pergjegjes/shef reparti anatomopatologji Shef Reperti Infektiv ne Psikiatri	10050	2%	0	14275	3700	Nga.deri ...Leke
10	Mjek Stomatolog Biolog Kimist	10050	2%	0	11900		Nga.deri ...Leke

	Fizikant Shef sektori Pergjegjes zyre						
11	Mjek infeksionist Mjek urgjence Mjek laborator Kimist, fizikant laborator Kimist ne sherbim gjaku	10050	2%	0	11900	600	Nga.deri ...Leke
12	Mjek onkolog Mjek kirurg (specialitete te ndryshme kirurgjikale) Mjek hematolog Mjek I bankes se gjakut Mjek obseter gjinekolog Mjek pneumoftiziater Mjek fizioterapevt	10050	2%	0	11900	1100	Nga.deri ...Leke
13	Mjek radiolog	10050	2%	0	11900	1600	Nga.deri ...Leke
14	Mjek higjenist Farmacist	10050	2%	0	11900	2500	Nga.deri ...Leke
15	Mjek anatomopatolog Mjek anaestezist reanimator Mjek,psikolog,punonjes sociale qe punojne ne psikiatri	10050	2%	0	11900	3700	Nga.deri ...Leke
16	Specialist i larte	10050	2%	0	10300		Nga.deri ...Leke

Lidhja nr.1 (Kreu 1.5)

**Struktura e pagave për punonjësit me arsim të lartë në Qendrën Kombëtare të
Kontrollit të Barnave**

EMERTIMI		PAGA MUJORE					
Nr.		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		Totali
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa per vjetërsi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa per pozicion (SHP)	Shtesa per kushte pune (SHKP)	
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor	10050	2%	0	33500		Nga..deri ...Leke
2	Zevendes drejtor	10050	2%	0	21550		Nga..deri ...Leke
3	Shef sektori	10050	2%	0	20650		Nga..deri ...Leke
4	Farmacist	10050	2%	0	16400		Nga..deri ...Leke
5	Analist	10050	2%	0	16400	2500	Nga..deri ...Leke
6	Farmacist inspektor per kontrollin farmaceutik	10050	2%	0	16400	2000	Nga..deri ...Leke
7	Specialist i larte	10050	2%	0	13275		Nga..deri ...Leke

Lidhja nr.1 (Kreu 1.6)

**Struktura e pagave për punonjësit me arsim të lartë në Qendrën e Shërbimeve
Mjekësore**

EMERTIMI		PAGA MUJORE					
Nr.		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa per vjetërsi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa per pozicion (SHP)	Shtesa per kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor	10050	2%	0	22800	2200	Nga..der i ...Leke
2	Shef sektori	10050	2%	0	16400		Nga..der i ...Leke
3	Mjek Stomatolog	10050	2%	0	14275		Nga..der i ...Leke

Lidhja nr.1 (Kreu 1.7)

**Struktura e pagave për punonjësit me arsim të lartë në Qendrën e Inxhinierisë
Biomjekësore**

EMERTIMI		PAGA MUJORE					
Nr.		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa per vjetërsi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa per pozicion (SHP)	Shtesa per kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor	10050	2%	0	20650		Nga..der i...Leke
2	Shef sektori Pergjegjes i zyres teknike Pergjegjes reparti	10050	2%	0	12000		Nga..der i...Leke
3	Specialist i larte	10050	2%	0	10300		Nga..der i...Leke

Lidhja nr.1 (Kreu 1.8)

Struktura e pagave për punonjësit me arsim të lartë në Qendrën Kombëtare e të Transfuzionit të Gjakut

EMERTIMI		PAGA MUJORE					
Nr.		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa per vjetërsi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa per pozicion (SHP)	Shtesa per kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor	10050	2%	0	22850		Nga..deri ...Leke
2	Zevendes drejtor	10050	2%	0	16400		Nga..deri ...Leke
3	Përgjegjës i sektorit të laboratoreve Shef i bankës së gjakut	10050	2%	0	14275	2500	Nga..deri ...Leke
4	Shef sektori	10050	2%	0	14275		Nga..deri ...Leke
5	Mjek, Kimist	10050	2%	0	14275	1100	Nga..deri ...Leke
6	Specialist i lartë	10050	2%	0	12000		Nga..deri ...Leke

Lidhja nr.1 (Kreu 1.9)

Struktura e pagave për punonjësit me arsim të lartë në Njësinë e Transportit Mjekësor me Helikopterë

EMERTIMI		PAGA MUJORE					
Nr.		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa per vjetërsi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa per pozicion (SHP)	Shtesa per kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Shef i Njësise	10050	2%	0	75258	8000	Nga..deri ...Leke
2	Pilot	10050	2%	0	56952	8000	Nga..deri ...Leke
3	Teknik helikopteri	10050	2%	0	54918		Nga..deri ...Leke
4	Shef sektori	10050	2%	0	16400		Nga..deri ...Leke
5	Specialist i lartë	10050	2%	0	13275		Nga..deri ...Leke

VENDIM
Nr.229, datë 19.4.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.638, DATË 18.9.2003, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË
PUNONJËSVE TË INFERMIERISTIKËS NË SISTEMIN E MINISTRISË
SË SHËNDETËSISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.638, datë 18.9.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.1, (Krerët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7 e 1.8) zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Lidhja nr.2 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për vitin 2006, për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore, të planifikuara në ligjin nr.9464, datë 28.12.2005, “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave, për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 15 prill 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1 (Kreu 1.1)

Struktura e pagave për punonjësit e infermieristikës në Qendrën Spitalore Universitar “Nënë
1316

**Tereza” Tiranë, Spitalin Universitar Obsetrik Gjinekologjik Tiranë, Spitalin e Sëmundjeve të
Mushkërive “Shefqet Ndroqi” Tiranë, Klinikën Stomatologjike Universitare Tiranë**

EMERTIMI		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa per vjetersi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa per pozicion (SHP)	Shtesa per kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Shef i sektorit te kujdesjeve infirmjorore Krye infirmjer sherbimi psikiatrik		2%	0	13500	3600	Nga..deri ...Leke
2	Kryelaborante ne sherbimin e anatomise patologjike; Kryeinfurmjer sherbimi terapise intensive; Kryeinfurmjere sherbimi onkologjik; Kryelaborant rezatim kobalti; Kryelaborant ne histopatologji; Kryeinfurmjere reparti i rezatimit; Kryeinfurmjer reparti psikiatrik.		2%	0	13500	3400	Nga..deri ...Leke
3	Kryeinfurmjere sherbimi neurokirurgji; Kryeinfurmjer/kryemami reparti i terapise intensive; Kryemami e pergjithshme.		2%	0	13500	2600	Nga..deri ...Leke
4	Kryeinfurmjere kimioterapi; Kryelaborant klinik biokimik; Kryinfurmjere ne urgjencen e semundjeve te brendeshme; Infirmjere ne hemodinamike; Kryeinfurmjiere/mami salle; Kryeinfurmjiere/mami e dhomes se zgjimit.		2%	0	13500	1800	Nga..deri ...Leke
5	Kryeinfurmjere sherbimi (kirurgji,neurologji,djegje plastik, kardiokirurgji,maksilofacial, infektiv, pediatri infektive);		2%	0	13500	1100	Nga..deri ...Leke

	Kryeinfemjer/kryemami ne repartin e kirurgjise; Krye mami turni ne kirurgji; Kryeinfemjere reparti (fizioterapi,urologji,urgjences se neuologjise,neurokirurgji, onkologji); Kryeinfemjere/kryemami salle operacioni.						
7	Kryeinfemjere sherbimi; Kryelaborante sherbimi; Kryemami sherbimi.		2%	0	13500		Nga..deri ...Leke
8	Infermjere ne psikiatri.		2%	0	12150	3700	Nga..deri ...Leke
9	Infermjere ne kyriterapi; Laborant histopatolog.		2%	0	12150	3400	Nga..deri ...Leke
10	Infermjere/Mami reanimacioni; Infermjere ne dhomen e zgjimit.		2%	0	12150	2650	Nga..deri ...Leke
11	Infermjere ne kimioterapi.		2%	0	12150	1800	Nga..deri ...Leke
12	Kryelaborant radiologjie.		2%	0	12150	1500	Nga..deri ...Leke
13	Specialist i sektorit te kujdesjeve infermjerore; Kryeinfemjere e edukimit shendetesor TB.		2%	0	12150	1100	Nga..deri ...Leke
14	Kryeinfemjer ne repartin e alergologjise; Kryeinfemjere ne sterilizim; Kryemami ne izolim; Laborant ne psikiatri.		2%	0	12150		Nga..deri ...Leke
15	Laborant radiolog ne psikiatri dhe onkologji.		2%	0	10900	3700	Nga..deri ...Leke
16	Laborant rezatim kobalti.		2%	0	10900	3400	Nga..deri ...Leke
17	Laborant ne mjeksine berthamore.		2%	0	10900	2650	Nga..deri ...Leke
18	Infermjere ne njesine e inspektoriatit sanitar dhe infeksioneve nozokomiale; Infermjere ne sallën e operacionit.		2%	0	10900	2100	Nga..deri ...Leke
19	Kryeinfemjer reparti pranim urgjence; Laborant klinik biokimik; Infermjer ne punktin e gjakut;		2%	0	10900	1800	Nga..deri ...Leke

	Infermjer ne hematologji; Infermjer ne onkologji; Infermjere endoskopie.						
20	Infermjere reparti radiologjik; Laborant radiolog; Kryeinfermjere (pranim urgjence,djegje plastike ,kirurgji).		2%	0	10900	1500	Nga..deri ...Leke
21	Infermjere /mami(kirurgji, maksilofaciale, neurokirurgji, kardiokirurgji, djegje plastike); Instrumentare.		2%	0	10900	1100	Nga..deri ...Leke
22	Kryemami sherbimi obsetrike; Kryeinfermjere neonatologji; Kryemami ne qendren e gruas; Kryemami pranimi; Kryeinfermjere ne kabinetin e dializes; Kryemami /Kryeinfermjere reparti; Kryeinfermjere konsultash ne semundjet e brendeshme; Kryelaborant (bakterolog,imunolog,ortopedi stomatologjike; Infermjere sterilizimi.		2%	0	10900		Nga..deri ...Leke
23	Infermjere pavioni rezatimi.		2%	0	9250	3310	Nga..deri ...Leke
24	Infermjere (infektiv,pranim urgjence,njesia e kordinimit te urgjences); Laborant(bakterolog, imunolog).		2%	0	9250	1800	Nga..deri ...Leke
25	Ndihmes farmacist; Infermjere ne hemodialize.		2%	0	9250	1500	Nga..deri ...Leke
26	Infermjer fizioterapi.		2%	0	9250	1100	Nga..deri ...Leke
27	Laborant (ezhe, ortopedi stomatologjike); Kryeinfermjere cerdhe per personelin; Infermjer.		2%	0	9250		Nga..deri ...Leke
27	Infermjer cerdhe per personelin; Kujdestar ne pediatri.		2%	0	8100		Nga..deri ...Leke
28	Kujdestar ne psikiatri.		2%	0	8100	2650	Nga..deri ...Leke

Lidhja nr.1 (Kreu 1.2)

Struktura e pagave për punonjësit e infermieristikës të Drejtorisë së Shëndetit Publik në rrethe

EMERTIMI		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa per vjetërsi (SHV)	Shtesa per Kualifi kim (SHK)	Shtesa per pozicion (SHP)	Shtesa per kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Shef i sektorit te kujdesjeve infermjereore.		2%	0	13750		Nga..deri ...Leke
2	Specialist i sektorit te kujdesjeve infermjerore; Infermer statistike.		2%	0	9250		Nga..deri ...Leke

Lidhja nr.1 (Kreu 1.3)

Struktura e pagave për punonjësit e infermieristikës në Drejtoritë e Kujdesit Shëndetësor Parësor dhe Shërbimet e Kujdesit Shëndetësor Parësor, Autoritetin Shëndetësor Rajonal të Tiranës.

EMERTIMI		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa per vjetërsi (SHV)	Shtesa per Kualifi kim (SHK)	Shtesa per pozicion (SHP)	Shtesa per kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Kryeinfermjer i pergjithshem.		2%	0	12150		Nga..deri ...Leke
2	Ndihmes inspektor sanitar,ndihmes higjenist, ndihmes epidemiolog; Laborante toksikologe.		2%	0	10900	1100	Nga..deri ...Leke
3	Infermjere ne psikiatri, qendren komunitare te shendetit mendor.		2%	0	10900		Nga..deri ...Leke
4	Infermjere (hematologji,onkologji); Laborant rontgeni.		2%	0	10900	1500	Nga..deri ...Leke
5	Infermjer ortopedi; Infermjer/laborant ne fizioterapi.		2%	0	9250	1100	Nga..deri ...Leke
6	Kryeinfermjer/kryemami; Infermjer ne sherbimin stomatologjik; Laborant bakterolog/klinikbiokimik; Ndihmes dentist.		2%	0	9250		Nga..deri ...Leke
7	Ndihmes bakterolog; Infermjer/mami.		2%	0	8600		Nga..deri ...Leke
8	Ndihmes infermjer.		2%	0	8100		Nga..deri ...Leke

Struktura e pagave për punonjësit e infermieristikës në Spitalet e retheve, Qendrën e Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve, Tiranë

EMERTIMI		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa per vjetërsi (SHV)	Shtesa per Kualifi kim (SHK)	Shtesa per pozicion (SHP)	Shtesa per kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Kryeinfermjer i përgjithshëm në spitalet psikiatrike.		2%	0	13500	2600	Nga..deri ...Leke
2	Kryeinfermjer reparti në spitalet psikiatrike.		2%	0	13500	2600	Nga..deri ...Leke
3	Kryeinfermjer i përgjithshëm.		2%	0	13500	1100	Nga..deri ...Leke
4	Laborant në anatomie patologjike.		2%	0	12150	3400	Nga..deri ...Leke
5	Kryelaborant në laboratorin klinik biokimik, bakterologjik; Kryeinfermjer (kirurgji , reanimacion, salla operacioni, obsetrike gjinekologji).		2%	0	12150		Nga..deri ...Leke
6	Kryeinfermjer.		2%	0	12150		Nga..deri ...Leke
7	Infermjere në psikiatri; Laborant në psikiatri.		2%	0	10900	2650	Nga..deri ...Leke
8	Infermjere reanimacion; Ndihmes anestezieste; Ndihmes farmacistë; Laborant radiologji; Infermier në radiologji; Instrumentare; Infermjere në hemodializë.		2%	0	9250	1500	Nga..deri ...Leke
9	Kryeinfermjere në poliklinikën e spitalit; Infermjer (fizioterapi, ergoterapi, logoterapi, neuropsikiatri, qendres së shëndetit mendor, infektiv, dispanceri të sëmundjeve të ngjyeshme, kirurgji, ortopedi, obsetrike, gjinekologji, pneumoftiziatri,		2%	0	9250	1100	Nga..deri ...Leke

	onkologji,dispanceri); Infermjere ne repartin e lindjes; Infermjer/laborant ne banken e gjakut, hematologji; Pergjegjes turni.						
10	Kryeinfermjere ne qendren e sterilizimit; Infermjer pranim urgjence; Laborant klinik biokimik /bakteriologjik.		2%	0	9250	600	Nga..deri ...Leke
11	Infermjer.		2%	0	9250		Nga..deri ...Leke
12	Kujdestar ne psikiatri.		2%	0	8100	2650	Nga..deri ...Leke
13	Kujdestar ne psikiatrine infective.		2%	0	8100	3300	Nga..deri ...Leke
14	Kujdestar ne pediatric; Ndihmes infermjer.		2%	0	8100		Nga..deri ...Leke

Lidhja nr.1 (Kreu 1.5)

Struktura e pagave për laborantët në Laboratorin e Kontrollit të Barnave

EMERTIMI		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa per vjetarsi (SHV)	Shtesa per Kualifi kim (SHK)	Shtesa per pozicion (SHP)	Shtesa per kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Laborant.		2%	0	11350		Nga..deri ...Leke

Lidhja nr.1 (Kreu 1.6)

Struktura e pagave për punonjësit e infermieristikës në Klinikën e Shërbimeve Mjekësore

EMERTIMI		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa per vjetarsi (SHV)	Shtesa per Kualifi kim (SHK)	Shtesa per pozicion (SHP)	Shtesa per kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Kryeinfermjer.		2%	0	13500		Nga..deri ...Leke
2	Infermjer; Ndihmes stomatologe.		2%	0	9250		Nga..deri ...Leke

Lidhja nr.1 (Kreu 1.7)

Struktura e pagave për punonjësit e infermieristikës në Qendrën e Kombëtare të Kontrollit të Gjakut

EMERTIMI		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Kryeinfermjer; Kryelaborant.		2%	0	12150		Nga..deri ...Leke
2	Infermjer; Laborant.		2%	0	9250	1100	Nga..deri ...Leke

Lidhja nr.1 (Kreu 1.8)

Struktura e pagave për tekniket në Njësinë e Transportit Mjekësor me Helikopterë

EMERTIMI		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Teknik i përgjithshëm; Teknik elektrik.		2%	0	12150		Nga..deri ...Leke

LIDHJA Nr.2

GRUPI	PAGA NE LEKE
1	9500
2	7600
3	6000

VENDIM
Nr.235, datë 19.4.2006

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.495, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE, TË PERSONAVE DHE SASISË SË NEVOJSHME TË KARBURANTIT PËR PËRDORIM NGA ANIJET E PESHKIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat” , të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.495, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Shoqëri furnizuese e gazoilit, për anijet e peshkimit të jetë “Armo” sh.a., Fier. Çmimi i shitjes së gazoilit pa akcizë të jetë 40 lekë/litër.”.

b) Pas pikës 3, shtohen pikat 3/1 e 3/2, me këtë përmbajtje:

“3/1. Efekti financiar prej 181 900 000 (njëqind e tetëdhjetë e një milion e nëntëqind mijë) lekësh, për 6-mujorin e dytë të vitit 2006, për diferencën ndërmjet çmimit të programuar vjetor të “Armo” sh.a., dhe çmimit 40 lekë/litër, t’i paguhet kësaj shoqërie nga fondet e Buxhetit të Shtetit.

3/2 Furnizimi i anijeve të peshkimit të mbështetet në normativat bazë të harxhimit të karburantit, sipas anijeve dhe llojit të peshkimit, në përputhje me tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

c) Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Në bazë të numrit të anijeve të peshkimit dhe të fuqisë së tyre motorike, sasia e gazoilit, për 1 vit, për nevojat e peshkimit sipas porteve, nuk duhet t’i kalojë sasi të mëposhtme:

- | | |
|---------------|---------------|
| i) Durrës | 7 200 tonë; |
| ii) Vlorë | 5 600 tonë; |
| iii) Shëngjin | 3 700 tonë; |
| iv) Sarandë | 1 500 tonë.”. |

ç) Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të nxjerrin udhëzimin e përbashkët për procedurat dhe dokumentacionin e duhur për shpërndarjen e karburantit, nga prodhuesi “Armo” sh.a., te përdoruesi.”.

d) Pika 7 shfuqizohet.

2. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA 1

NORMATIVAT TEKNIKE DHE TEKNOLOGJIKE TË KONSUMIT TË KARBURANTIT PËR ANIJET E PESHKIMIT

I. Peshkimi fundor – Pellagjik (Koeficienti Lit/Kg = 0.84)

A- Anije peshkimi 150 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 150 = 24.7 \text{ kg/orë} = 29.3 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $29.3 \times 0.7 = 20.5 \text{ lit/orë}$

B- Anije peshkimi 300 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 300 = 49 \text{ kg/orë} = 58.2 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $58.2 \times 0.7 = 40.8 \text{ lit/orë}$

C- Anije peshkimi 400 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 400 = 66 \text{ kg/orë} = 78.4 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $78.4 \times 0.7 = 54.9 \text{ lit/orë}$

D- Anije peshkimi 600 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 600 = 99 \text{ kg/orë} = 117.6 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $117.6 \times 0.7 = 82.3 \text{ lit/orë}$

E- Anije peshkimi 1000 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 1000 = 165 \text{ kg/orë} = 196 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $196 \times 0.7 = 137.2 \text{ lit/orë}$

II. Peshkimi me rrethim

A- Anije peshkimi 80 deri 600 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 300 = 49 \text{ kg/orë} = 58.2 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $58.2 \times 0.50 = 29.1 \text{ lit/orë}$

III. Peshkimi selektiv

A- Anije peshkimi 80 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 80 = 14.4 \text{ kg/orë} = 17 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $17 \times 0.7 = 12 \text{ lit/orë}$

B- M/Fluga peshkimi 40 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 40 = 6.6 \text{ kg/orë} = 8 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $8 \times 0.7 = 5.6 \text{ lit/orë}$

C- M/Lanca peshkimi 20 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 20 = 3.4 \text{ kg/orë} = 4 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $4 \times 0.7 = 2.8 \text{ lit/orë}$

D- M/Lanca peshkimi 10 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 10 = 1.7 \text{ kg/orë} = 2 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $2 \times 0.7 = 1.4 \text{ lit/orë}$

Në përlllogaritjet e konsumit faktik të karburantit për anije dhe forma të ndryshme peshkimi janë marrë në konsideratë:

1. Gjysmë orë ndezje e motorit në bankinë para nisjes për të arritur parametrat teknikë të punës, si dhe praktikë nisje.

2. Në Durrës e Vlorë, dy orë ecje e lirë deri në zonën e peshkimit dhe dy orë kthim në port.
 3. Në Shëngjin dhe Sarandë, një orë ecje e lirë deri në zonën e peshkimit dhe një orë kthim në port.
 4. 20% e kohës në peshkim, llogaritet në lëshim veglash peshkimi dhe virim.
 5. 10% ecje e lirë, motori në minimum, grisje e karikim trate, kolaudim pajisje peshkimi etj.
 6. Rreth 60% e kohë pune efektive, tralim.
 7. Janë marrë në konsideratë edhe rastet e kthimit në port pa peshkim, për kohë të keqe, difekte teknike etj.
 8. Të gjitha përlllogaritjet, kanë si qëllim të përcaktojnë vetëm konsumin orar të karburantit, e për rrjedhojë sasia e karburantit që do të rimbursohet del nga koha e punës faktike në det të anijes, shumëzuar me konsumin e aprovuar në orë të paraqitur më sipër.
- Në përfundim përcaktimi i normativës së harxhimit të karburantit për anijet e peshkimit, është bërë në vija të përgjithshme mbi bazën e formulës:

$$K = 0.70 \times HP(\max.) \times \frac{S}{D} \times T$$

K--- Konsumi i karburantit të motorit për një kohë të caktuar

0.70 --- Koeficient mesatar i përdorimit të motorit

HP (max) -- Fuqi maksimale e motorit në HP (kuaj fuqi)

S --- Konsumi specifik i motorit sipas llojeve në gr/hp/orë

$$\frac{155-180}{2} = 165$$

D---- Densiteti i karburantit = 0.84

T----- Koha në punë e motorit, (e cila mund të zëvendësohet me distancën e përshkruar në milje, pjesëtuar me shpejtësinë në nyje të anijes)

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat me vendimin nr.340, datë 28.3.2006 vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Ilo Xheladini i datëlindjes 11.12.1954, lindur dhe banues në Berat.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK	1500
(2006).....	
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
.....	
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

Botime të reja

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

Hyri në shtyp më 3.5.2006
Doli nga shtypi më 7.5.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë